



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Agim Ramadani tel. +381 (0) 38 551 679; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

KOMUNIKATË

22.10.2009

Presidenti i Republikës z. Fatmir Sejdiu, Kryeministri z. Hashim Thaçi dhe Ambasadori i SHBA-ve z. Kristofer Dell, kanë vizituar sot në orën 11.00 selinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ata janë pritur nga kryetarja e KQZ- së znj. Nesrin Lushta dhe nga Kryeshefi i SKQZ-së z. Xhemajl Peqani. Kryetarja Nesrin Lushta, i ka falënderuar dy personalitetet më të larta të vendit dhe ambasadorin Dell për vizitën dhe, i ka njoftuar ata lidhur me procesin dhe me përgatitjet intensive që po bëhen për Zgjedhjet Lokale të 15 nëntorit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Presidenti Fatmir Sejdiu, Kryeministri Hashim Thaçi dhe ambasadori Kristofer Dell kanë falënderuar KQZ-në për pritjen dhe, e kanë siguruar kryetaren Nesrin Lushta për mbështetjen e institucioneve më të larta të vendit dhe të faktorëve të tjerë relevant për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe, për gjith procesin zgjedhor. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për herë të parë organizon zgjedhje në mënyrë të pavarur.